



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 mars 2016
Nr. ref.:RK904/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastet e bashkuara nr.
KI102/15 dhe KI115/15**

Parashtrues

Ilmi Gashi dhe Naser Raçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 76/2015, të 2 prillit 2015,
dhe
Rev. nr. 89/2015, të 15 prillit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI102/15, është dorëzuar nga z. Ilmi Gashi, ndërsa kërkesa KI115/15, është dorëzuar nga z. Naser Raçi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

A. Sa i përket kërkesës KI102/15

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 76/2015, të 2 prillit 2015.

B. Sa i përket kërkesës KI115/15

3. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 89/2015, të 15 prillit 2015, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 qershor 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se është *“shkelur e drejta e Kushtetutës, neni 49”*.

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 korrik 2015, parashtruesi Ilmi Gashi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 9 shtator 2015, parashtruesi Naser Raçi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 19 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 1 tetor 2015, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës KI102/15, në Gjykatën Supreme.
10. Më 20 tetor 2015, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës KI115/15 në Gjykatën Supreme.
11. Më 25 nëntor 2015, Kryetarja e Gjykatës, urdhëroi bashkimin e kërkesës KI115/15 me kërkesën KI102/15. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë me atë që ishte vendosur me Vendimin nr. KSH. KI102/15.
12. Më 26 nëntor 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit dhe Gjykatën Supreme për bashkimin e kërkesave.

13. Më 22 dhjetor 2015, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

A. Sa i përket kërkesës KI102/15

14. Në një datë të pacaktuar në vitin 2005, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK), e aprovoi kërkesën e parashtruesit për pension nën kategorinë "A" (Vendimi nr. 45), në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.
15. Me vendimet e lartcekura u përcaktua se pagesa e pensionit për parashtruesin e kërkesës do të jetë për një periudhë të caktuar prej 5 (pesë) vitesh (prej 1 prillit 2005 deri më 1 maj 2010), ndërsa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 euro. Për më tepër, në vendim thuhet se pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e kontesteve.
16. Sipas dokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar asnjë ankesë ndaj këtij vendimi.
17. Siç specifikohet në marrëveshje, KEK kishte ndërprerë pagesën e pensionit të parashtruesit të kërkesës, pas datës së fundit.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
19. Më 13 maj 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1021/2010) refuzoi, si të pabazuara paditë e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore konstatoi se "*KEK-u ka përmbushur obligimin në bazë të marrëveshjes dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar kur është nënshkruar marrëveshja*".
20. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
21. Më 26 shkurt 2004, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 3925/2013) e refuzoi, si të pabazuar ankesën dhe i vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore.

"Meqë në marrëveshjen e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës në nenin e kësaj marrëveshje është paraparë që kjo marrëveshje të fillojë nga dt. 01.04.2005 dhe do të përfundon pas pagesës prej 60 muajve, e cila përfundon me dt. 01.05.2010, kjo pagesë është paraparë në nenin 2.1 pika al. të marrëveshjes gjegjësisht statutit të Fondit Pensional Invalidor dhe të vdekurve të Korporatës Energjetike të Kosovës, me dt. 01.11.2002. Nga kjo rezulton se e paditura ka përmbushur obligimin në bazë të marrëveshjes së cituar më lart, përkatësisht vendimit nr. 45 të dt. 24.03.2005, në të cilin vendim është përcaktuar saktë data kur fillon pagesa e pensionit me dt. 01.04.2005 dhe përfundon me dt.01.05.2010, gjithashtu është përcaktuar saktë se kur përfituesi i këtij pensioni do t'i ndërprehet dhe atë si me datën e cituar më lart. Shuma e pensionit është përcaktuar në shumë prej 105 euro.

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka mundur të ushtrojë ankesë dhe se një të drejtë të tillë paditësi nuk e ka shfrytëzuar. Andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar”.

22. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
23. Më 2 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 76/2015) e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion.
24. Gjykata Supreme konstatoi:

“Gjykata Supreme e Kosovës, arsyetimin e aktgjykimit të gjykatave të instancës më të ulët e ka pranuar si të drejtë, meqë paditësi vetë ka aplikuar për pensionim, e cila kërkesë i është miratuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut, dhe në bazë të këtyre fakteve e paditura me Vendimin nr. 45 datë 24.3.2005, ka informuar paditësin për kushtet konkrete të pensionimit. Me vendimin e cekur më lart të paditurës, është përcaktuar se pagesa e pensionit fillon më 1.4.2005 dhe përfundon më 1.5.2010, në lartësinë mujore prej 105 €. Kundër këtij vendimi paditësi ka mundur të paraqesë ankesë Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes administratës së Fondit Pensional, por ankesë nuk ka ushtruar dhe pensionin e ka pranuar gjer më 1.5.2010. Kjo Gjykatë vlerëson se paditësi është pajtuar që marrëdhënien e tij të punës ta shndërrojë në marrëdhënie tjetër juridike, ndërsa thëniet e revizionit se paditësi ndërkohë është aftësuar për punë, por nuk është pranuar kthimi i tij në punë e as që është vazhduar pagesa. Gjykata Supreme e shqyrtoi por e njëjta nuk pat ndikim për të vendosur ndryshe, ngase në vendimin e të paditurës është cekur se (me këtë vendim zëvendësohen të gjitha aktet e gjertanishme të nënshkruara në mes KEK-ut dhe shfrytëzuesit). Kjo Gjykatë vlerëson se e paditura ka përmbushur obligimin e saj ndaj paditësit, ngase ka vepruar konform vendimit të cekur i cili nuk është kundërshtuar nga paditësi. Me nenin 11.1, pika (b) të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, është paraparë se kontrata e punës mund të shkëputet me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit”.

B. Sa i përket kërkesës KI115/15

25. Në një datë të pacaktuar në vitin 2004, Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK), e aprovoi kërkesën e parashtruesit për pension nën kategorinë “A” (Vendimi nr. 140), në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut.
26. Me vendimet e lartcekura u përcaktua se pagesa e pensionit për parashtruesin e kërkesës do të jetë për një periudhë të caktuar prej 5 (pesë) vitesh (prej 1 korrikut 2004 deri më 1 gusht 2010), ndërsa shuma e pensionit mujor do të jetë 105 euro. Për më tepër, në vendim thuhet se pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e kontesteve.

27. Sipas dokumenteve të dorëzuara, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar asnjë ankesë ndaj këtij vendimi.
28. Siç specifikohet në marrëveshje, KEK kishte ndërprerë pagesën e pensionit të parashtruesit të kërkesës, pas datës së fundit.
29. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
30. Më 27 shkurt 2012, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 1333/2011) i refuzoi paditë e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Themelore konstatoi se *“KEK-u ka përmbushur obligimin në bazë të marrëveshjes dhe asnjë ankesë nuk është parashtruar kur është nënshkruar marrëveshja”*.
31. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
32. Më 11 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi AC. nr. 5267/2012) e refuzoi, si të pabazuar ankesën dhe i vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore, duke theksuar që.

“Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë se paditësi ka shkuar në pension të parakohshëm si invalid i kategorisë së 3-të, sipas kërkesë-aplikimit të tij, i cili i është lejuar me Vendimin e të paditurës nr. 140/53, i datës 13.7.2004, i cili gjen mbështetje në Rregulloren e UNMIK-ut nr. i 2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të të paditurës, e që pagesa e paraparë e pensionit i është bërë në lartësinë mujore prej 105,00 €, për pesë vite, duke filluar nga data 1.7.2004 dhe i ka përfunduar me datë 1.8.2009. Ky vendim e ka pasur edhe këshillën juridike, se pala e pakënaqur ka të drejtë të ushtroj ankesë kundër tij, gjë që paditësi asnjëherë nuk e ka bërë, çka nënkupton se ai është pajtuar me të njëjtin në të gjitha pjesët e tij, edhe sa i përket kohës së pensionimit e edhe lartësisë së pagesës, prandaj, ky vendim ka marrë formën e prerë dhe është zbatuar në përpikëri nga e paditura e cila e ka përmbushur detyrimin e vet të pagesës ndaj paditësit për gjatësinë kohore prej 5 vitesh, prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se paditësit i mungon baza ligjore për miratimin e kërkesëpadisë së tij, me çka pajtohet edhe kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë”.

33. Parashtruesi parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
34. Më 15 prill 2015, Gjykata Supreme (Rev. nr. 89/2015) e refuzoi, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion.
35. Gjykata Supreme konstatoi:

“Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit se nga ana e gjykatave të shkallës më të ulët, çështja e paditësit nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me çështjet tjera të palëve tjera, edhe pse lidhur me të njëjtën gjendjen faktike e juridike ekziston aktgjykimi i

Gjykatës Kushtetuese edhe për 26-ish punëtor të paditurës, kërkesa e të cilëve është pranuar. Gjykata Supreme gjen se këto pretendime të revizionit nuk qëndrojnë për faktin se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në të cilin paditësi është thirrur në revizion nuk i referohet çështjes kontestuese të cilën paditësi e ka ngritur në gjykatë, por i njëjti ka të bëjë me situatën në të cilën raportet mes të paditurës dhe punëtorëve të caktuar janë rregulluar me një marrëveshje të veçantë, sipas të cilës e paditura është detyruar që këtë pagesë mujore prej 105 €, në muaj t'ua bëjë gjer në formimin e Fondit Pensional e Invalidor të Kosovës, ndërsa në rastin konkret raporti në mes paditësit dhe të paditurës është rregulluar me një vendim i cili nga e paditura është marrë sipas aplikimit të paditësit për pension të parakohshëm, dhe me të njëjtin është pranuar aplikimi dhe kërkesa e paditësit për pension të parakohshëm me kohëzgjatje të caktuar prej 5 viteve, dhe e paditura sipas këtij vendimi ka kryer obligimin e pagesës së këtij pensioni, ndërsa në të njëjtin vendim nuk është paraparë vazhdimi i kësaj pagese edhe pas periudhës 5 vjeçare të precizuar në këtë vendim. Paditësi ka qenë në dijeni për kohëzgjatjen e këtij pensioni të precizuar në këtë vendim, mirëpo ka pranuar këto kushte të pagesës së këtij pensioni, dhe kundër këtij vendimi nuk është ankuar. Për këto arsye Gjykata Supreme, pranon në tërësi si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të shkallës së parë sipas të cilit e paditura pa një vendim, marrëveshje apo ndonjë rregullore apo akt të brendshëm juridik, respektivisht pa ndonjë bazë ligjore, nuk është e detyruar që paditësit t'ia vazhdojë pagesën e këtij pensioni të parakohshëm, gjer në arritjen e moshës për pension prej 65 vjet, të paraparë me ligj”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me aktgjykimet e kontestuarra të Gjykatës Supreme të Kosovës “janë shkelur të drejtat e tyre të punës të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”.
37. Parashtruesit pretendojnë se “ishin të informuar se nëse shëndeti i punëtorit është përmirësuar, punëtori kthehet në punë”.
38. Përveç kësaj, parashtruesit kërkuan nga Gjykata Kushtetuese të “anulojë aktgjykimet e gjykatave të ulëta dhe ti kthejë parashtruesit në punë”.

Pranueshmëria e kërkesës

39. Së pari, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
41. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(d) *parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*”.

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin mbi baza kushtetuese dhe nuk kanë dhënë prova që dëshmojnë se të drejtat dhe liritë e tyre themelore janë shkelur nga gjykatat e rregullta.
43. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë sa që procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë sa që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih, *ndër autoritete të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).
44. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i ka arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme aktgjykimet e saj dhe Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
45. Gjykata rikujton se rastet e tjera të KEK-ut në të cilat janë referuar parashtruesit e kërkesës (p.sh. KI40/09) janë gjykuar lidhur me kompensimin e përkohshëm për shpërbërjen e marrëdhënies së punës nga KEK-u. Megjithatë, Gjykata vëren se kërkesat e tanishme KI102/15 dhe KI115/15 dallojnë nga rastet e lartcekura (p. sh., KI40/09). Në të vërtetë, në këto raste, KEK-u dhe ish-punonjësit tjerë nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm deri në krijimin e Fondit Pensional dhe Invalidor të Kosovës me referencë për një datë të pacaktuar, përderisa në rastin konkret KI102/15 dhe KI115/15, KEK-u dhe ish-punonjësit tjerë nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, pra duke iu referuar një date të caktuar.
46. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kishin shpjeguar pse dhe si ishin shkelur të drejtat e tyre të punës, të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës. Deklarata e thjeshtë, se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga ana e gjykatës së rregullt, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
47. Pra, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

48. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, kërkesat janë qartazi të pabazuara dhe rrjedhimisht, të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) (d) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 dhjetor 2015, njëzëri

VENDOS

- I. T'I DEKLAROJË kërkesat të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović




Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
